

V E N D I M
Nr.465, datë 3.10.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.47, DATË
7.2.1994 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË
PRIVATIZOHET OSE VENDOSËT NË SHOQËRITË E PËRBASHKËTA, SI DHE
PËRCAKTIMI I QIRASË PËR OBJEKTE SHTETËRORE QË U JEPEN NË PËRDORIM TË
TRETËVE”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Industrisë e Tregtisë dhe Ministrisë së Bujqësisë e Ushqimit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.47, datë 7.2.1994, në kapitullin I shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“Për elementet e pasurisë të ardhura nga ndihmat shtetërore e që krijojnë fond kundërparti, si makineri e pajisje, pjesë këmbimi, lëndë të para, materiale e mallra të ndryshme, vlefte e të cilave në momentin e privatizimit nuk u është likuiduar furnitorëve ose buxhetit të shtetit, vlera aktuale minimale (VAMI) të përcaktohet sipas çmimit të blerjes ose kriterëve e kompetencave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.511, datë 26.10.1993”.

2. Në kapitullin V shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“Në rastet e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore pas daljes së këtij vendimi, detyrimet e krijuara nga ndihmat shtetërore të likuidohen menjëherë nga të ardhurat e privatizimit dhe të derdhen në llogaritë e furnitorëve (dhe këta të fundit në llogarinë e fundit kundërparti), ose drejtpërdrejt në llogarinë e fondit kundërparti, sipas skemës së përcaktuar nga Ministria e Financave për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Pjesa e mbetur nga të ardhurat e privatizimit ndahet sipas kriterëve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.234, datë 24..1994 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme””, pika 20. Po kështu të veprohet edhe në rastet e privatizimit të reparteve, linjave teknologjike etj., të një ndërmarrjeve shtetërore, që kanë përfituar ndihma shtetërore dhe nuk është bërë likuidimi i detyrimit përkatës.

Në të gjitha rastet që pas privatizimeve personave fizikë a juridikë privatë u janë lënë në përdorim ndihma shtetërore në formën e kredisë mall, prej tyre të likuidohet brenda vitit 1994 e gjithë vlera e fondit kundërparti.

Kur ndërmarrjet shtetërore kalojnë tërësisht në shoqëri të përbashkëta, janë të detyruara të likuidojnë më parë detyrimet për ndihmat shtetërore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi